

Programi IPA 2013 i Bashkimit Evropian për Shqipërinë



Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën

(EuropeAid/135700/DH/SER/AL)

DRAFTI FINAL I VKM

“DISPOZITA TË POSACME NË LEJET E MJEDISIT PËR IMPIANTET E MËDHA ME DJEGIE”

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian





Titulli i Projektit:	Asistencë Teknike për Forcimin e Kapaciteteve Institucionale të Ministrisë së Mjedisit për Zbatimin e Legjislacionit Evropian për Mjedisin dhe Klimën
Akronimi i Projektit:	IBECA
Numri i Projektit:	Europe Aid/135700/DH/SER/AL
Data e fillimit të projektit:	22 Qershor 2015
Data e përfundimit të projektit:	21 Dhjetor 2018
Autoriteti Kontraktues:	Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri ABA Business Centre Rruga Papa Gjon Pali II, Tirana, Albania. Z. Kai NAGEL, Menaxher Sektori, Mjedisi & Energjia Tel: +355 4 222 8320, Fax: +355 4 223 0752 e-mail: Kai.NAGEL@eeas.europa.eu
Përfituesi:	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit Rruga “Norbert Jokl”, ish ATSH, Tiranë, Shqipëri. Evisi Kopliku Drejtor, Drejtoria e Integritimit, Koordinimit, Marreveshjeve dhe Asistences Mob: +355694397595 e-mail: Evisi.Kopliku@turizmi.gov.al
Kontraktori:	Agrotec SpA Lungotevere Michelangelo, 9 - 00192 Roma, Italia Kastriot Koshaj Menaxher Projekti Tel: +39 063609381, Fax: +39 0636093861 e-mail: info@agrotec-spa.net
Titulli i Dokumentit:	Drafti Final i VKM “Dispozita të posacme në lejet e mjedisit për Impiantet e mëdha me djegie”

Shënim:

Ky raport është përgatitur nga një ekip i projektit që punon për Agrotec. Gjetjet, konkluzionet dhe interpretimet e shprehura në këtë dokument janë vetëm të Agrotec dhe nuk duhet të konsiderohen në asnjë mënyrë sikur reflektojnë opinionet dhe politikat e Komisionit Evropian.

Autori i draft VKM:

Prof.Ass.Dr.MSc. Narin PANARITI – Zevendes Drejtuese e Projektit – narin_panariti@yahoo.co.uk

Data e raportit: 18 Tetor 2018

Tabela e permbajtjes

Seksioni 1 - Qëllimi.....	4
Seksioni 2 - Objekti.....	4
Seksioni 3 - Përjashtimet.....	4
Seksioni 4 - Përkufizime	5
Seksioni 5 - Rregullat për agregimin e kapaciteteve.....	6
Seksioni 6 - Vlerat kufi të shkarkimeve	6
Seksioni 7 - Norma e desulfurizimit	7
Seksioni 8 - Prodhimi i kombinuar i energjisë dhe nxehtësisë.....	8
Seksioni 9 - Depozitimi gjeologjik i dioksidit të karbonit	8
Seksioni 10 - Keqfunksionimi ose avaritë në pajisjet për reduktimin e shkarkimeve.....	9
Seksioni 11 - Vetëmonitorimi i shkarkimeve në ajër	9
Seksioni 12 - Respektimi i vlerave kufi të shkarkimeve	9
Seksioni 13 - Impiantet që përdorin disa lëndë djegëse.....	10
Seksioni 14 - Raportimi	10
Seksioni 15 - Dispozita përfundimtare.....	11
Shtojcë: Dispozita teknike në lidhje me impiantet e mëdha të djegies.....	12
SEKSIONI 1: Vlerat kufi të shkarkimeve për impiantet me djegie tëpërmendur në Seksionin 6(2).....	12
PJESA 2: Monitorimi i shkarkimeve.....	14
PJESA 3: Vlerësimi i respektimit të vlerave kufi të shkarkimeve	16
PJESA 4: Norma minimale e desulfurizimit	16
PJESA 5: Pajtueshmëria me normën e desulfurizimit	16
PJESA 6: Vlerat mesatare kufi të shkarkimeve për impiantet me djegie që përdorin lëndë djegëse të përziera brenda një rafinerie	17



DRAFT FINAL
18.10.2018

VENDIM

Nr.... datë.....

“DISPOZITA TË POSACME NË LEJET E MJEDISIT PËR IMPIANTET E MËDHA ME DJEGIE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe *nenit xxx të draftit 2 versionit 1* të Ligjit “Për lejet e mjedisit”, Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit

VENDOSI:

Seksioni 1 - Qëllimi

Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë disa kushte shtesë për lejet e mjedisit të tipit A të përcaktuara në draft 2 version 1 të ligjit “Për lejet e mjedisit”, që janë specifike për Impiantet e Mëdha me Djegie (IMD).

Seksioni 2 - Objekti

Neni 28 Objekti

1. Ky vendim zbatohet për impiantet me djegie, kapaciteti termik nominal i të cilëve është i barabartë ose më i madh se 50 MW, pavarësisht llojit të lëndës djegëse të përdorur.
2. Ai zbatohet vetëm për impiantet me djegie që janë projektuar për prodhimin e energjisë, me përjashtim të atyre që i përdorin drejtpërdrejt produktet e djegies në proceset e prodhimit.

Seksioni 3 - Përjashtimet

Neni 28 Objekti

Ky vendim nuk zbatohet për këto impiante me djegie:

- (a) impiante në të cilat produktet e djegies përdoren për nxehjen, tharjen e drejtpërdrejtë ose çfarëdolloj trajtimi tjetër të objekteve ose të materialeve;
- (b) impiantet e pas-djegies të projektuar për pastrimin e mbetjeve të gazta nga djegia, të cilat nuk funksionojnë si impiante të pavarura me djegie;
- (c) objektet për rigjenerimin e katalizatorëve të fraksionimit katalitik;
- (d) objektet për shndërrimin e sulfurit të hidrogjenit në sqfur;
- (e) reaktorët e përdorur në industrinë kimike;
- (f) furrat e koksit;
- (g) cilindrat cowpers;
- (h) çdo aparaturë teknike që përdoret për krijimin e forcës shtytëse të automjeteve, anijeve apo avionëve;
- (i) turbinat e gazit dhe motorët me gaz që përdoren në platformat e hapura në det;
- (j) impiantet që përdorin si lëndë djegëse çfarëdolloj mbetje të ngurtë ose të lëngët, me përjashtim të mbetjeve të përmendura në germën (b) të paragrafit 8 të Seksionit 4.

Seksioni 4 - Përkufizime

Neni 3 Përkufizime

Për qëllime të këtij vendimi, të gjithë termat kanë të njëjtin kuptim si në draft ligjin “Për lejet e mjedisit”, kurse termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. 'lëndë djegëse' është çdo lëndë djegëse e ngurtë, e lëngshme ose e gaztë;
2. 'impiant me djegie' është çdo pajisje teknike në të cilën oksidohen lëndët djegëse me qëllim që të përdoret nxehtësia e prodhuar në këtë mënyrë;
3. 'oxhak' është një strukturë që përmban një ose më shumë gypa për shkarkimin e mbetjeve të gazta në atmosferë;
4. 'orë pune' është koha, e shprehur në orë, gjatë së cilës i gjithë ose një pjesë e një impianti me djegie është në funksion dhe shkarkon mbetje të gazta në atmosferë, me përjashtim të fazës së fillimit dhe ndalimit;
5. 'norma e desulfurizimit' është raporti, për një periudhë të caktuar, midis sasisë së sqfurit që nuk shkarkohet në atmosferë nga një impiant me djegie dhe sasisë së sqfurit që gjendet në lëndën djegëse të ngurtë të futur në pajisjet e impiantit me djegie dhe të përdorur në impiant gjatë së njëjtës periudhë;
6. 'lëndë djegëse e ngurtë e prodhuar në vend' është lënda djegëse e ngurtë natyrore e djegur në një impiant me djegie të projektuar posaçërisht për atë lëndë djegëse, e cila nxirret në vend;
7. 'biomasë' janë të gjitha produktet e mëposhtme:
 - a. produktet e përbëra nga një lëndë bimore bujqësore ose pyjore që mund të përdoret si lëndë djegëse me qëllim përdorimin e përmbajtjes së saj energjetike;
 - b. mbetjet e mëposhtme:
 - i. mbetjet nga bujqësia dhe pyjet;
 - ii. mbetjet bimore nga industria e përpunimit të ushqimeve, nqse nxehtësia e prodhuar mund të rikuperohet;
 - iii. mbetjet bimore me bazë fibre të dala nga prodhimi i brumit të papërpunuar dhe nga prodhimi i letrës nga brumi, nqse ato bashkëdigjen në vendin e prodhimit dhe nqse nxehtësia e prodhuar mund të rikuperohet
 - iv. mbetjet e tapave të drurit;

- v. mbetjet drusore me përjashtim të atyre që mund të përmbajnë përbërje organike halogjene apo metale të rënda si rezultat i trajtimit me konservantë ose veshje drusore dhe që përfshin, në veçanti, të tilla mbetje drusore që e kanë origjinën nga mbetjet e ndërtimit dhe shëmbjet e ndërtesave;
8. 'impiant me furrë djegie të përzier' është çdo impiant djegie që mund të ushqehet njëkohësisht ose në mënyrë të njëpasnjëshme nga dy ose më shumë lloje të lëndëve djegëse;
 9. 'turbinë me gaz' është çdo aparat rrotullues që konverton energjinë termike në punë mekanike, që përbëhet kryesisht nga një kompresor, një pajisje termike për oksidimin e lëndës djegëse në mënyrë që të nxehet lëngu i punës, dhe një turbinë;
 10. 'motor me gaz' është motori me djegie të brendshme, i cili për të djegur lëndën djegëse punon me ciklin Otto dhe përdor ndezjen me shkëndijë ose, në rastin e motorëve me dy lëndë djegëse, ndezjen me kompresion;
 11. 'motor me naftë' është një motor me djegie të brendshme, i cili punon sipas ciklit të naftës dhe përdor ndezjen me kompresion për të djegur lëndën djegëse;
 13. "D_{proc}"ka kuptimin e dhënë në Shtojcën 2 të Vendimit Nr.178, datë 6.3.2012 "Për incinerimin e djegieve". Shtojca VI. Pjesa 4. Paragrafi 1.
 14. "D_{ëaste}"ka kuptimin e dhënë në Shtojcën 2 të Vendimit Nr.178 datë 6.3.2012 "Për incinerimin e mbetjeve". Shtojca VI. Pjesa 4. Paragrafi 1.
 15. "AKM" është Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila është autoriteti kompetent për lëshimin e lejeve të mjedisit.
 16. "Ministri" është ministri përgjegjës për mjedisin.
 17. "ISHM" është Inspektorati Shtetëror përgjegjës për Mjedisin.
 18. "LM" është Leje Mjedisi.
 19. "IMD" është Impiant i Madh me Djegie.

Seksioni 5 - Rregullat për agregimin e kapaciteteve

Neni 29 Rregullat për bashkimet

1. Kur mbetjet e gazta të dy ose më shumë impianteve të ndara me djegie shkarkohen përmes një oxhaku të përbashkët, kombinimi i krijuar nga këto impiante konsiderohet si një impiant i vetëm me djegie dhe kapaciteti i secilit prej tyre mblidhet për efekt llogaritjeje të fuqisë termike nominale totale.
2. Për qëllim të llogaritjes së fuqisë termike nominale totale të një kombinimi impiantesh me djegie të përmendur në paragrafin 1, impiantet individuale me djegie me fuqi termike nominale nën 15 MW nuk merren parasysh.

Seksioni 6 - Vlerat kufi të shkarkimeve

Neni 30 Vlerat kufi të shkarkimeve

1. Mbetjet e gazta nga impiantet me djegie do të shkarkohen në mënyrë të kontrolluar nëpërmjet oxhakut, i cili përmban një ose më shumë gypa, lartësia e të cilit do të llogaritet në mënyrë të tillë që të mbrojtë shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

2. Të gjitha lejet për instalimet që përmbajnë impiante me djegie duhet të përmbajnë disa kushte që sigurojnë mostejkalimin e vlerave kufi të shkarkimeve në ajër nga këto impiante të përcaktuara në Pjesën 1 të Shtojcës së këtij vendimi.
3. Vlerat kufi të shkarkimeve dhe normat minimale të desulfurizimit të përcaktuara respektivisht në Pjesën 1 dhe Pjesën 4 të Shtojcës së këtij vendimi vlejné për shkarkimet e secilit oxhak të përbashkët në lidhje me fuqinë termike nominale totale të të gjithë impiantit me djegie. Aty ku Shtojca e këtij vendimi përcakton se vlerat kufi për shkarkimet mund të aplikohen për një pjesë të impiantit me djegie me një numër të kufizuar orësh pune, ato vlera kufi duhet të aplikohen për shkarkimet e asaj pjese të impiantit, por duhet të vendosen në lidhje me fuqinë termike nominale totale të të gjithë impiantit me djegie.
4. AKM mund të bëjë një përjashtim, për një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, duke çliruar nga detyrimi për t'ju përmbajtur vlerave kufi të shkarkimeve të përcaktuara në paragrafin 2 për dioksidin e squfurit, për një impiant me djegie që zakonisht përdor lëndë djegëse me përqindje të ulët squfuri, në rastet kur operatori nuk është në gjendje t'u përmbahet këtyre vlerave kufi për shkak të - ndërprerjes së furnizimit me lëndë djegëse me përqindje të ulët squfuri që shkaktohet nga mungesa e madhe e tij në treg.
5. AKM e njofton menjëherë Ministrinë për çdo përjashtim të bërë sipas pikës 4.
6. AKM mund të bëjë përjashtime nga detyrimi për t'iu përmbajtur vlerave kufi të shkarkimeve të përcaktuara në paragrafin 2 në rastet kur një impiant me djegie që përdor vetëm lëndë djegëse të gazta duhet të përdorë përjashtimisht lëndë djegëse të tjera për shkak të një ndërprerje të papritur në furnizimin me gaz dhe për këtë arsye do t'i duhet të pajiset me pajisje për pastrimin e mbetjeve të gazta. Periudha për të cilën jepet një përjashtim i tillë nuk mund të tejkalojë 10 ditë, me përjashtim të rasteve kur ekziston një nevojë jetike për të mbajtur furnizimin me energji elektrike.
7. AKM e njofton menjëherë Ministrinë për çdo rast specifik të përmendur në paragrafin 6.
8. AKM e njofton menjëherë Ministrinë për çdo përjashtim të bërë sipas pikës 6.
9. Kur zgjerohet një impiant me djegie, vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 1 të Shtojcës duhet të zbatohen për pjesën e zgjeruar të impiantit që është prekur nga ndryshimi dhe vlerat do të përcaktohen në raport me fuqinë termike nominale totale të të gjithë impiantit me djegie.
10. Në rastin e ndryshimeve në një instalim me djegie që mund të kenë ndikim në mjedis dhe që prekin një pjesë të instalimit me fuqi termike nominale prej 50 MW ose më shumë, vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 1 të Shtojcës duhet të zbatohen për atë pjesë të impiantit e cila është ndryshuar në raport me fuqinë termike nominale totale të të gjithë impiantit me djegie.
11. Vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 1 të Shtojcës së këtij vendimi nuk zbatohen për impiantet e mëposhtme me djegie:
 - (a) motorët me naftë;
 - (b) kaldajat për rikuperimin e nxehtësisë në instalimet për prodhimin e brumit të letrës.

Seksioni 7 - Norma e desulfurizimit

Neni 31 Norma e desulfurizimit

1. Për impiantet me djegie që djegin lëndë djegëse të ngurta të prodhuara në vend, të cilat nuk mund të përmbushin vlerat kufi të shkarkimeve për dioksidin e sulfurit përmendur në Seksionin 6, paragrafi 2 për shkak të karakteristikave të kësaj lënde djegëse, AKM mund të aplikojë normën minimale të desulfurizimit të përcaktuar në Pjesën 4 të Shtojcës së këtij vendimi, në përputhje me

rregullat e përputhshmërisë të përcaktuara në Pjesën 5 të saj dhe me vlerësimin paraprak të AKM të **raportit teknik** përmendur në Seksionin 14, paragrafi 5.a.

2. Për impiantet me djegie që djegin lëndë djegëse të ngurta të prodhuara në vend, të cilat bashkë-incinerojnë mbetje, dhe të cilat nuk i përmbushin vlerat e D_{proc} për dioksidin e sulfurit të përcaktuara në Shtojcën II, II.2.1 Vlerat mesatare ditore të Vendimit Nr. 178, datë 6.3.2012 “Për incinerimin e mbetjeve”, për shkak të karakteristikave të lëndës djegëse të ngurtë të prodhuar në vend, AKM mund të aplikojë normat minimale të desulfurizimit të përcaktuara në Pjesën 4 të Shtojcës së këtij Vendimi, në përputhje me rregullat e përputhshmërisë të përcaktuara në Pjesën 5 të asaj Shtojce.
3. Në rastin e përmendur në paragrafin 2, D_{waste} , vlerat kufi të shkarkimeve për impiantet e incinerimit të mbetjeve përmendur në Vendimin Nr. 178, datë 6.3.2012 “Për incinerimin e mbetjeve” duhet të jenë të barabarta me 0 mg/Nm^3 .

Seksioni 8 - Prodhimi i kombinuar i energjisë dhe nxehtësisë

1. Formulari i kërkesës për leje mjedisi të tipit A duhet të kërkojë nga operatori i impiantit me djegie që të paraqesë gjetjet e studimit të fizibilitetit teknik dhe ekonomik të prodhimitt të kombinuar të energjisë dhe nxehtësisë.
2. Në rastet kur ky fizibilitet konfirmohet, duke pasur parasysh tregun dhe sistemin e shpërndarjes, AKM duhet të kërkojë në lejet e mjedisit të tipit A që operatori t’i zhvillojë këto instalime në përputhje me këtë mënyrë prodhimi.

Seksioni 9 - Depozitimi gjeologjik i dioksidit të karbonit

Neni 36 Depozitimi gjeologjik i dioksidit të karbonit

1. Kur jepet një leje mjedisi e tipit A për çdo impiant me djegie me prodhim energjie elektrike prej 300 megavat ose më shumë, për të cilët leja origjinale e ndërtimit ose, në mungesë të një procedurë të tillë, leja origjinale e shfrytëzimit është dhënë pas hyrjes në fuqi të legjislacionit specifik për depozitimin gjeologjik të dioksidit të karbonit, AKM duhet të ketë vlerësuar nëse operatori i përmbush kushtet e mëposhtme:
 - (a) ka në dispozicion vend-depozitime të përshtatshme,
 - (b) mënyrat dhe mjetet e transportit janë teknikisht dhe ekonomikisht të realizueshme,
 - (c) është teknikisht dhe ekonomikisht e mundur që paisjet për kapjen e dioksidit të karbonit t’i shtohen/përshtaten më vonë një impianti ekzistues.
2. Në qoftë se kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 përmbushen, AKM duhet t’i kërkojë operatorit të sigurojë një hapësirë të përshtatshme në vendin e instalimit për pajisjet që nevojiten për kapjen dhe ngjeshjen e dioksidit të karbonit.
3. AKM duhet të përcaktojë nëse plotësohen kushtet, në bazë të vlerësimit të bërë sipas paragrafit 1 dhe të informacioneve të tjera në dispozicion, veçanërisht kushtet për mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

Seksioni 10 - Keqfunksionimi ose avaritë në pajisjet për reduktimin e shkarkimeve

Neni 37 Keqfunksionimi ose defektet në pajisjet për reduktimin e shkarkimeve

1. Në hartimin e lejeve të mjedisit të tipit A për çdo impiant me djegie që është subjekt i këtij vendimi, AKM duhet të parashikojë procedura për mosfunksionimin ose avaritë e pajisjeve për reduktimin e shkarkimeve.
2. Lejet e mjedisit të tipit A duhet të kërkojnë nga operatori që në rast avarie:
 - a) nëse nuk arrin të kthejë operimin normal brenda 24 orëve, ta reduktojë ose ta ndërpresë operimin e impiantit ose ta operojë atë duke përdorur lëndë djegëse më pak ndotëse.
 - b) brenda 48 orësh nga keqfunksionimi apo avaria në pajisjet e reduktimit të shkarkimeve të njoftojë AKM.
 - c) të mos tejkalojë 120 orë kohëzgjatje të akumuluar të operimit pa reduktim shkarkimesh për një periudhë 12 mujore.
3. AKM mund të bëjë përrjashtime nga afatet kohore të përcaktuar në paragrafin 2, germa a dhe në një nga rastet e mëposhtme:
 - (a) ekziston një nevojë jetike për të mbajtur të pandryshuar furnizimin me energji;
 - (b) impianti me djegie që ka pësuar avari rrezikon të zëvendësohet për një periudhë të kufizuar nga një impiant tjetër, i cili do të shkaktonte rritjen e shkarkimeve në përgjithësi.

Seksioni 11 - Vetëmonitorimi i shkarkimeve në ajër

Neni 38 Monitorimi i shkarkimeve në ajër

1. Në përgatitjen e lejeve të mjedisit të tipit A për çdo impiant me djegie që është subjekt i këtij vendimi, AKM i vendos operatorit kërkesa për vetëmonitorimin e shkarkimeve në ajër.
2. Vetëmonitorimi i lëndëve që ndotin ajrin bëhet nga operatori në përputhje me Pjesën 3 të Shtojcës së këtij vendimi.
3. Instalimi dhe funksionimi i pajisjeve monitoruese automatike i nënshtrohet kontrollit dhe - testeve të përvitshme nga Inspektorati Shtetëror për Mjedisin, siç përcaktohet në Pjesën 3 të Shtojcës së këtij vendimi.
4. AKM përcakton vendndodhjen e pikave të marrjes së mostrave ose të matjes që do të përdoren nga operatori për vetëmonitorimin e shkarkimeve.
5. AKM do t'i kërkojë operatorit që të gjitha rezultatet e vetëmonitorimit t'i regjistrojë, përpunojë dhe paraqesë në mënyrë të tillë që t'i mundësojnë AKM të verifikojë përputhshmërinë me kushtet e veprimtarisë dhe me vlerat kufi të shkarkimeve që janë përcaktuar në leje.
6. Ministri, me propozim të AKM, lëshon Urdhrin për përpunimin, formën e regjistrimit dhe paraqitjen e rezultateve të vetëmonitorimit.

Seksioni 12 - Respektimi i vlerave kufi të shkarkimeve

Neni 39 Respektimi i vlerave kufi të shkarkimeve

ISHM do të konsiderojë që vlerat kufi të shkarkimeve në ajër janë respektuar nëse operatori ka plotësuar kushtet e përcaktuara në Pjesën 4 të Shtojcës së këtij Vendimi.

Seksioni 13 - Impiantet që përdorin disa lëndë djegëse

Neni 40 Impiantet që përdorin disa lëndë djegëse

1. Në rastin e një impianti me djegie me disa lëndë djegëse, i cili përdor njëkohësisht dy ose më shumë lëndë djegëse, AKM duhet të përcaktojë vlerat kufi të shkarkimeve në përputhje me hapat e mëposhtëm:
 - (a) merren vlerat kufi të shkarkimeve individualisht për çdo lëndë djegëse dhe ndotës që i korrespondon fuqisë termike totale të të gjithë impiantit me djegie, siç përcaktohet në Pjesën 2 të Shtojcës së këtij vendimi;
 - (b) përcaktohen vlerat kufi të shkarkimeve të ponderuara për lëndë djegëse; këto vlera përftohen duke shumëzuar vlerat kufi të shkarkimeve individuale të referuara në paragrafin (a) me fuqinë termike të nxjerrë nga çdo lëndë djegëse dhe duke pjesëtuar rezultatin e shumëzimit me shumën e fuqive termike të nxjerra nga të gjitha lëndët djegëse,
 - (c) shtohen vlerat kufi të shkarkimeve të ponderuara për lëndë djegëse.

Seksioni 14 - Raportimi

Neni 72.3.4 Raportimi nga Shtetet Anëtare

1. Për të gjitha impiantet me djegie në RSh që mbulohen nga ky vendim, AKM bën një inventar vjetor të dioksidit të squfurit, oksideve të azotit dhe shkarkimeve të pluhurit dhe inputit të energjisë.
2. Duke pasur parasysh rregullat e agregimit të përcaktuara në Seksionin 4 “Rregullat e agregimit”, përdoruesi i çdo impianti djegie, i paraqet AKM këto të dhëna:
 - (a) fuqinë termike nominale totale (në MW) të impiantit me djegie;
 - (b) llojin e impiantit me djegie: kaldajë, turbinë me gaz, motor me gaz, motor naftë, të tjerë (duke saktësuar llojin);
 - (c) datën e fillimit të funksionimit të impiantit me djegie;
 - (d) shkarkimet totale vjetore (ton në vit) të dioksidit të squfurit, oksideve të azotit dhe pluhurave (si total grimcash në pezulli);
 - (e) numrin e orëve të punës të impiantit me djegie;
 - (f) inputin total vjetor të energjisë, në raport me vlerën e tij kalorifike neto (TJ në vit), zbrërthyer sipas kategorive të mëposhtme të lëndës djegëse: qymyr, linjit, biomasë, torfë, lëndë djegëse tjera të ngurta (duke saktësuar llojin), lëndë djegëse të lëngëta, gaz natyror, gazra të tjera (duke saktësuar llojin).
3. Operatori, i komunikon Ministrisë, me kërkesë, të dhënat vjetore të këtij inventari për secilin impiant.
4. Një përmbledhje e inventarëve i komunikohet Ministrisë çdo 3 vjet, brenda 12 muajve nga përfundimi i periudhës së parë trevjeçare të operimit të impiantit me djegie, e në vazhdim. Kjo përmbledhje tregon veçmas të dhënat për impiantet me djegie brenda rafinerive.
5. Çdo vit AKM i raporton Ministrisë këto të dhëna:
 - (a) për impiantet me djegie për të cilat zbatohet Seksioni 6 “Norma e desulfurizimit”, përmbajtjen e squfurit në lëndën djegëse të ngurtë të prodhuar në vend që është përdorur dhe normën e arritur e desulfurizimit, të shprehur si mesatare mujore. Për vitin e parë, ku zbatohet Seksioni 6 “Norma e desulfurizimit”, raportohen edhe arsyet teknike të pamundësisë së pajtueshmërisë

me vlerat kufi të shkarkimeve të referuara në Seksionin 5, paragrafi 2 “Vlerat kufi të shkarkimeve”; dhe

- (b) për impiantet me djegie që në mënyrë të përsëritur nuk punojnë më shumë se një mesatare prej 1500 orë pune në vit gjatë një periudhe 5 vjecare, numri i orëve të punës në vit.

Seksioni 15 - Dispozita përfundimtare

1. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ministria, ministria përgjegjëse për industrinë, AKM dhe Inspektorati Shtetëror përgjegjës për mjedisin dhe Inspektorati Shtetëror përgjegjës për industrinë.
2. Ky vendim do të botohet në Gazetën Zyrtare dhe hyn në fuqi me hyrjen në fuqi të draft ligjit “Për lejet e mjedisit”.

MINISTRI

BLENDI KLOSI

Shtojcë: Dispozita teknike në lidhje me impiantet e mëdha të djegies

SHTOJCA V Dispozita teknike në lidhje me impiantet e djegies

SEKSIONI 1: Vlerat kufi të shkarkimeve për impiantet me djegie tëpërmendur në Seksionin 6(2)

PJESA 2 Vlerat kufi të shkarkimeve për impiantet me djegie tëpërmendur në nenin 30 (3)

1. Të gjitha vlerat kufi të shkarkimeve do të llogariten në temperaturën 273.15 K, në presion 101.3 kPa dhe pas korigjimit në funksion të përmbajtjes në avuj uji të mbetjeve të gazta për një përmbajtje standarde prej 6% në O₂ për lëndët djegëse të ngurta, 3% për impiantet me djegie përveç turbinave me gaz dhe motorëve me gaz që përdorin lëndë djegëse të lëngshme dhe të gazta dhe 15% për turbinat me gaz dhe motorët me gaz.

Për turbinat e gazit me cikël të kombinuar me djegie suplementare, përmbajtja e standardizuar e O₂ mund të përcaktohet nga AKM, duke marrë parasysh karakteristikat specifike të instalimit në fjalë.

2. Vlerat kufi të shkarkimeve (mg/Nm³) të SO₂ për impiantet me djegie që djegin lëndë djegëse të ngurta ose të lëngshme me përjashtim të turbinave me gaz dhe motorëve me gaz

Fuqia termike nominale totale (MW)	Qymyri, linjiti dhe lëndë djegëse të tjera të ngurta	Biomasa	Torfa	Lëndët djegëse të lëngshme
50-100	400	200	300	350
100-300	200	200	300 250 për djegien me shtrat të lëngëzuar	200
> 300	150 200 për djegien me shtrat të lëngëzuar qarkullues ose nën presion	150	150 200 për djegien me shtrat të lëngëzuar	150

3. Vlerat kufi të shkarkimeve (mg/Nm³) për SO₂ për impiantet me djegie që përdorin lëndë djegëse të gaztë me përjashtim të turbinave me gaz dhe motorëve me gaz

Në përgjithësi	35
Gaze të lëngëzuara	5
Gaze me fuqi të ulët kalorifike nga furrat e koksit	400
Gaze me fuqi të ulët kalorifike nga furnaltat	200

4. Vlerat kufi të shkarkimeve (mg/Nm³) për NO_x për impiantet me djegie që përdorin lëndë djegëse të lëngshme me përjashtim të turbinave me gaz dhe motorëve me gaz

Kapaciteti termik nominal (MW)	Qymyri, linjiti dhe lëndë të tjera djegëse të ngurta	Biomasa dhetorfa	Lëndët djegëse të lëngshme
50-100	300 400 në rastin me djegie së linjtit të pluhurizuar	250	300
100-300	200	200	150
> 300	150 200 në rastin me djegie së linjtit të pluhurizuar	150	100

5. Turbinat me gaz (përfshirë turbinat e gazit me cikël të kombinuar distilate të lehta CCGT) që përdorin distilate të lehta dhe të mesme si lëndë djegëse të lëngshme i kanë vlerat kufi të shkarkimeve 50 mg/Nm³ për NO_x dhe 100 mg/Nm³ për CO.

Turbinat me gaz për përdorim për emergjence që operojnë për më pak se 500 orë pune në vit nuk mbulohen nga vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në këtë pikë. Operatori i këtyre impianteve do t'i regjistrojë orët e shfrytëzuara të punës.

6. Vlerat kufi të shkarkimeve (mg/Nm³) për NO_x dhe CO për impiantet me djegie që djegin gaz

	NO _x	CO
Impiante me djegie të ndryshme nga turbinat me gaz dhe motorët me gaz	100	100
Turbinat me gaz (përfshirë CCGT – turbina me gaz me cikël të kombinuar)	50 ⁽⁷⁾	100
Motorët me gaz	75	100

Për turbinat me gaz (përfshirë CCGT), vlerat kufi të shkarkimeve të NO_x dhe CO të përcaktuara në këtë pikë vlejnë vetëm për ngarkesa më të larta se 70 %.

⁽⁷⁾ Për turbinat e gazit me cikël të thjeshtë me rendiment më të lartë se 35 % – përcaktuar sipas kushteve ISO të ngarkesës bazë-vlera kufi e shkarkimeve për NO_x është 50xη/35, ku η është rendimenti i turbinës me gaz në kushtet e ngarkesës bazë ISO të shprehur në përqindje.

Shënim në tabelën 6 të Pjesës 2 të Shtojcës V.

Turbinat me gaz dhe motorët me gaz të emergjencave që operojnë më pak se 500 orë pune në vit nuk mbulohen nga vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në këtë pikë. Operatori i këtyre impianteve duhet t'i regjistrojë orët e shfrytëzuara të punës.

7. Vlerat kufi të shkarkimeve (mg/Nm³) për pluhurin në impiantet me djegie që përdorin lëndë djegëse të ngurtë ose të lëngshme me përjashtim të turbinave me gaz dhe motorëve me gaz

Kapaciteti termik nominal (MW)	
50-300	20
> 300	10 20 për biomasën dhe torfën

8. Vlerat kufi të shkarkimeve (mg/Nm³) për pluhurin në impiantet me djegie që përdorin lëndë djegëse të gaztë me përjashtim të turbinave me gaz dhe motorëve me gaz

Në përgjithësi	5
Gazet nga furnalata	10
Gazet e prodhuar nga industria e çelikut që mund të përdoren për qëllime të tjera	30

PJESA 2: Monitorimi i shkarkimeve

PJESA 3 Monitorimi i shkarkimeve

- Përqendrimet e SO₂, NO_x dhe pluhurit në mbetjet e gazta nga secili impiant me djegie me kapacitet termik nominal prej 100 MW ose më shumë do të maten në mënyrë të vazhdueshme.
Përqendrimi i CO në mbetjet e gazta nga secili impiant me djegie që djeg lëndë djegëse të gaztë me kapacitet termik nominal prej 100 MW ose më shumë do të matet në mënyrë të vazhdueshme.
- AKM mund të vendosë të mos kërkojë matjen e vazhdueshme që përmendet në pikën 1 në këto raste:
 - për impiantet me djegie me jetëgjatësi prej më pak se 10 000 orësh pune;
 - për SO₂ dhe pluhurin nga impiantet me djegie që djegin gaz natyror;
 - për SO₂ nga impiantet me djegie që djegin naftë me përmbajtje të njohur sulfuri në rastet ku nuk ka pajisje për desulfurizimin e mbetjeve të gazta;
 - për SO₂ nga impiantet me djegie që djegin biomasë nëse operatori mund të vërtetojë se shkarkimet e SO₂ nuk mund të jenë në asnjë mënyrë më të larta sesa vlerat kufi të përcaktuara të shkarkimeve.
- Në rastet kur nuk kërkohen matje të vazhdueshme, do të kërkohen matjet e SO₂, NO_x, pluhurit dhe, për impiantet që djegin gaz, edhe të CO të paktën një herë çdo 6 muaj.
- Për impiantet me djegie që përdorin qymyrin ose linjitin si lëndë djegëse, një herë në vit duhet të maten shkarkimet totale të merkurit.
- Si alternativë për matjet e SO₂ dhe NO_x të referuara në pikën 3, mund të përdoren procedura të tjera të verifikuara dhe të miratuara nga AKM për të përcaktuar shkarkimet e SO₂ dhe NO_x. Këto procedura do të kryhen në përputhje me standardet e CEN (Komiteti Evropian për Standardizimin)

ose, nëse nuk ekzistojnë standarde CEN, do të zbatohen standardet ISO, standarde të tjera kombëtare ose ndërkombëtare që sigurojnë ofrimin e të dhënave me cilësi të njëjtë shkencore.

6. Operatori do të njoftojë AKM për ndryshimet e rëndësishme në llojin e lëndës djegëse të përdorur apo në mënyrën e funksionimit të impiantit. AKM do të vendosë nëse kërkesat e monitorimit të përcaktuara në pikat 1 deri 4 janë ende të mjaftueshme apo kanë nevojë të përshtaten.
7. Matje të vazhdueshme sipas pikës 1 do të bëhen për përmbajtjen e oksigjenit, temperaturës, presionit dhe avujve të ujit në mbetjet e gazta. Nëse përpara se të analizohen shkarkimet e gazta, mostra e mbetjes së gazta është tharë, matjet e vazhdueshme të përmbajtjes së avujve të ujit në këto mbetje nuk janë të nevojshme.
8. Marrja e mostrave dhe analiza e substancave të rëndësishme ndotëse dhe matjet e parametrave të procesit, si dhe garantimi i cilësisë së sistemeve matëse të automatizuara dhe metodat referencë të matjeve për të kalibruar këto sisteme duhet të kryhet në përputhje me standardet CEN. Nëse nuk ekzistojnë standarde CEN, do të zbatohen standardet ISO, standarde të tjera kombëtare ose ndërkombëtare që sigurojnë ofrimin e të dhënave me cilësi të njëjtë shkencore.

Sistemet e automatizuara të matjeve i nënshtrohen kontrollit me anë të matjeve paralele me metodat referencë të paktën një herë në vit.

Operatori duhet të njoftojë AKM për rezultatet e kontrollit të sistemeve të automatizuara të matjeve.

9. Për vlerat kufi të shkarkimeve, vlerat e intervalit të besimit prej 95% të një rezultati të vetëm matje nuk duhet të tejkalojnë përqindjet e mëposhtme të vlerave kufi të shkarkimit:

Monoksidi i karbonit	10 %
Dioksidi i squfurit	20 %
Oksidet e azotit	20 %
Pluhuri	30 %

10. Vlerat mesatare orare dhe ditore të validuara do të përcaktohen nga vlerat e matura mesatare orare të validuara pasi u është zbritur vlera e intervalit të besimit të specifikuar në pikën 9.

Nuk do të merren fare parasysh dita që, për shkak të mosfunksionimit ose mirëmbajtjes së sistemit të automatizuar të matjeve, ka më shumë se tre vlera mesatare orare të pavlefshme. Nëse për situata të tilla gjatë një viti shpallen të pavlefshme më shumë se 10 ditë, AKM do t'i kërkojë operatorit të marrë masat e duhura për të përmirësuar besueshmërinë e sistemit matës të automatizuar.

11. Në rastin e impianteve që duhet të përshtaten me normat e desulfurizimit të përmendur në Seksionin 7, në monitorim të rregullt duhet të jetë edhe përmbajtja e squfurit në lëndën djegëse të djegur në atë impiant. Opeartori do të njoftojë AKM për ndryshime të konsiderueshme të llojit të lëndës djegëse të përdorur.

PJESA 3: Vlerësimi i respektimit të vlerave kufi të shkarkimeve

PJESA 4 Vlerësimi i respektimit të vlerave kufi të shkarkimeve

1. Kur bëhen matje të vazhdueshme, vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 1 do të konsiderohen të zbatuara nëse vlerësimi i rezultateve të matjeve tregon se, për orët e punës brenda një viti kalendarik, janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

- (a) asnjë vlerë mesatare mujore e validuar nuk tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 1;
- (b) asnjë vlerë mesatare ditore e validuar nuk tejkalon 110% të vlerës kufi të shkarkimeve përkatëse të përcaktuar në Pjesën 1;
- (c) në rastet e impianteve me djegie të përbërë vetëm nga kaldaja që përdorin qymyr, me fuqi termike nominale totale më të ulët se 50 MW, asnjë vlerë mesatare ditore e vlefshme nuk e tejkalon 150% të vlerave kufi të shkarkimeve të përcaktuara në Pjesën 1,
- (d) 95% e të gjitha vlerave mesatare për orë të vlefshme gjatë vitit nuk tejkalon 200% të vlerave kufi të shkarkimevetë përcaktuara në Pjesën 1.

Vlerat mesatare të validuara përcaktohen në pajtim me pikën 10 të Pjesës 2.

2. Vlerat mesatare të validuara përcaktohen në pajtim me pikën 10 të Pjesës 2.

PJESA 4: Norma minimale e desulfurizimit

PJESA 5 Norma minimale e desulfurizimit

Norma minimale e desulfurizimit për impiantet e djegies përmendur në Seksionin 6(3)

Fuqia termike nominale totale (MW)	Norma minimale e desulfurizimit
50-100	93 %
100-300	93 %
> 300	97 %

PJESA 5: Pajtuëshmëria me normën e desulfurizimit

PJESA 6 Pajtuëshmëria me normën e desulfurizimit

Norma minimale e desulfurizimitparashikuar në Pjesën 4 të kësaj Shtojce aplikohet si vlerë kufi mesatare mujore.

PJESA 6: Vlerat mesatare kufi të shkarkimeve për impiantet me djegie që përdorin lëndë djegëse të përziera brenda një rafinerie

PJESA7 Vlerat mesatare kufi të shkarkimeve për impiantet me djegie që përdorin lëndë djegëse të përziera brenda një rafinerie

Vlerat mesatare kufi të shkarkimeve (mg/Nm^3) të SO_2 për impiantet me djegie që përdorin disa lëndë djegëse brenda një rafinerie, me përjashtim të turbinave me gaz dhe motorëve me gaz, të cilat përdorin tepëricat e procesit të distilimit dhe konvertimit nga rafinimi i naftës bruto, vetëm ose më lëndë të tjera djegëse, për konsum vetjak: $600 \text{ mg}/\text{Nm}^3$.

Këto vlera kufi të shkarkimeve llogariten në temperaturën 273.15 K, në presion 101.3 kPa dhe pas korigjimit në funksion të përmbajtjes së avujve të ujit në mbetjet e gazta me përmbajtje standarde 6% në O_2 për lëndët djegëse të ngurta dhe 3% për lëndët djegëse të lëngëta ose të gazta.